

AGK, UNKT dhe AAB shënojnë Ditën e OKB-së

25 tetor 2021

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës – AGK, në bashkëpunim me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT) dhe Kolegjin AAB, sot me anë të një tryeze diskutimi shënoi Ditën e Kombeve të Bashkuara.

Diskutimi mbi lajmet e rreme dhe verifikimin e fakteve gjatë pandemisë në Kosovë u zhvillua me studentët e Komunikimit Masiv të Kolegjit AAB. Paneli u udhëhoq nga Kryetari i AGK-së, Xhemajl Rexha, ndërsa panelistë pjesëmarrës ishin gazetarët Jehona Zhitia, Bujar Vitija, Arbreshë Uka, Gentiana Hasani dhe Anđelka Ćup.

Studentët e pranishëm më nga afër u njoftuan me vështirësitë gjatë raportimit në kohë pandemie, si dhe sfidat e gazetarëve në luftimin e lajmeve të rreme dhe dezinformatave.

Dita e OKB-së shënon përvjetorin e hyrjes në fuqi të Kartës së OKB-së në vitin 1945. Me ratifikimin e këtij dokumenti nga shumica e nënshkruesve të tij, përfshirë pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit, Kombet e Bashkuara u krijuan zyrtarisht. 24 Tetori është festuar si Dita e Kombeve të Bashkuara që nga viti 1948.

AGK në bashkëpunim me UNKT në vazhden e aktiviteteve për përmbushjen e SDG-ve, më 5 nëntor do të ndanë çmimet mbi raportimet më të mira për çrrënjosjen e varfërisë. Njëheriz falënderojmë të gjitha agjencitë e Ekipit të OKB-së në Kosovë, posaçërisht ato që këtë herë përkrahën bashkëpunimin për: shënimin e ditës së OKB-së dhe Çmimit të Gazetarëve për Çrrënjosjen e Varfërisë: Zyra e Koordinatorit të OKB-së Për Zhvillim-UNDCO, Agjencisë së OKB-së për Refugjatë- UNHCR, UN Operations- UNOPS, Pogramit për Zhvillim të OKB-së- UNDP, Agjencia për shëndetin seksual dhe riprodhues e OKB-së-UNFPA si dhe Agjencisë për Barazi Gjinore dhe fuqizim të Grave- UN Women.